



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.107/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Komunën e Prizrenit, për shkak të vendosjes së posterit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Komunën e Prizrenit, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 27.09.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 26.09.2019 në rrugën Zahir Pajaziti në Prizren monitoruesit e tyre kanë hasur në poster të kandidatit për deputet nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), të ngjitur në hapsira publike-mbi rrugë. Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtresuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 28.09.2019, subjekti politik (PREBK), thekson se vendosja e posterit në rrugën “Zahir Pajaziti” është bërë nga simpatizantë të kesaj lagje të cilët të entuziazmuar dhe me qëllim për të informuar komunitetin Rom të kesaj lagje kanë vendosur posterin e kandidatit për deputet nga ky subjekt politik. Me tej shtojnë se kjo shkelje ligjore ka ndodhur në mungesë të mos informimit të simpatizantëve të kesaj lagje Rome dhe se posterit i cili ishte i vendosur mbi rrugë publike ka qëndruar vetëm 24 orë, pas marrjes së informatës nga PZAP-i, partia PREBK në afate të caktuar e ka larguar posterin, gjë që e dëshmojnë edhe me fotot e bashkangjitura në përgjigje në ankesë. PREBK që nga themelimi i saj në vitin 2000 ka qene pjesëmarrëse në të gjitha Zgjedhjet Parlamentare të Kosovës, dhe asnjëherë nuk është gjobitur nga PZAP-i, për shkak të shkeljeve të tilla gjatë fushatës zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se e njëjta është e bazuar, për këto arsye:

Paneli konstaton se nga fotografia e ofruar në cilësinë e provës, nga paraqitësi i ankesës shihet qartë se me vendosjen e posterit mbi rrugë publike nga ana e subjektit politik PREBK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, të cilën shkelje e ka pohuar edhe vet subjekti politik PREBK, nëpërmes përgjigjen në ankesë.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që në rastin konkret rezulton se subjekti politik PREBK, nuk ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike në zgjedhjet e kaluara, dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh pretendimet e subjekti politik PREBK, se nuk kanë qenë të njoftuar se si dhe ku mund te vendosen posteret reklamues, mirëpo këto pretendime janë të paqëndrueshme ngase i njëjti subjekt politik ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe kodin e mirësjelljes. Rrethanat që kanë ndikuar që paneli t'i shqipton gjobën me të ulët se sa gjobat që përcaktohen me Rregullën Nr. 01/2012 të PZAP-it, për natyrë shkeljes, janë se subjekti politik PREBK, ka bërë përmirësimin e shkeljes brenda afatit të dhënë nga PZAP-i, dhe rrethana tjetër që ka ndikuar është fakti se për herë të parë subjektit politik PREBK, i shqiptohet gjobë për thyerjen e Kodit të Mirësjelljes, të cilat rrethana kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar me lart, paneli në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c) dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.107/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuesi i Panelit

Zynda Haxhiu



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.